



SHLUIJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



UNESCO Chair in Multiculturalism,
Intercultural Dialogue and
Human Rights in the Balkans
ShLUIJ, Universiteti Marin Barleti, Albania

SHKOLLA E LARTE UNIVERSITARE JOPUBLIKE
"UNIVERSITETI MARIN BARLETI"
FAKULTETI I DREJTËSISË

MASTER PROFESIONAL NE "E DREJTE PUBLIKE"

Miratohet

Përgjegjësi i Departamentit
Dr. Ilir Panda

SYLLABUS I LËNDËS

MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

TIRANË, 2014

TITULLI I LËNDËS

“Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”

LLOJI I LËNDËS

Lënda bazë

KREDITET:

6

KOHA E REALIZIMIT:

Semestri I

PËRSHKRIMI I MODULIT/ KURSIT:

Programi i lëndës “Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, është hartuar sipas modeleve të universiteteve më të njohura të botës. Kjo lëndë synon të pajisë studentët me njohuritë themelore teorike dhe praktike për të Drejtat e Njeriut nëpërmjet studimit të instrumenteve kryesore ligjorë dhe *quasi* ligjorë, të të drejtës së butë dhe të drejtës së fortë (*soft and hard law*) ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, si dhe institucionet kryesore që garantojnë zbatimin e këtyre instrumenteve.

Të Drejtat e Njeriut nuk mund të kuptohen jashtë konceptit të shoqërisë njerëzore dhe nuk mund të zhvishen nga karakteri universal i tyre. Ato janë të lidhura ngushtë me detyrimin e shtetit për t’i respektuar, për t’i mbrojtur dhe promovuar ato. Fillesat e të Drejtave të Njeriut i gjejmë shumë kohë më parë në pikëpamjet filozofike në të ashtuquajturën demokracinë klasike ose “foshnjore” në Greqinë e Lashtë e të filozofëve të tjerë të shquar si: Niccolo Machiaveli, Hugo Grotius i cili njihet edhe si babai i të Drejtës Ndërkombëtare, Thomas Hobbes në pikëpamjet e tij mbi raportin ndërmjet qytetarëve dhe monarkut apo qytetarëve me shtetin në veprën e tij “The Leviathan” (Leviatan), John Locke i cili njihet edhe si Babai i Liberalizmit filozofik e politik, veçanërisht në veprat e tij, “The Second Treatise on Civil Government” (Traktati i dytë mbi qeverisjen civile), “The True End of Civil Government” (Qëllimi i vërtetë i qeverisjes civile) etj, Montesquieu, Jeremy Betham, James Mill, Jean Jacques Rousseau në veprën e tij të famshme “The Social Contract” (Kontrata Sociale), John Stuart Mill i cili ka trajtuar për herë të parë në nivel akademik të drejtën e vetëvendosjes, Mary Ëollstonecraft, e cila ka trajtuar për herë të parë të drejtat e grave etj.

Në ditët tona të Drejtat e Njeriut kanë evoluar shumë, falë pikëpamjeve të reja mbi shtetin, duke e vlerësuar e trajtuar demokracinë si një sistem qeverisjeje i cili ngrihet mbi respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, e deri të ideve të reja libertokratike të Gregory Flanagan mbi një rend të ri botëror të quajtur Libertokraci (Libertocracy) etj. Sidoqoftë të gjithë këto ide, teori, filozofi dhe studiues nuk kanë pasur synim tjetër veçse të sqarimit dhe vendosjes së një raporti sa më të drejtë ndërmjet njerëzve dhe shtetit, ndërmjet të dobëtut dhe të fortit, ndërmjet të pasurit dhe të varfrit, ndërmjet etnive, kombeve dhe popujve si dhe të mbrojtjes të dinjitetit njerëzor i cili përbën thelbin e të Drejtave të Njeriut.

Në dallim nga trajtimi i deritanishëm që është bërë në Shqipëri lënda i kushton një kujdes të veçantë dhe trajtim tjetërllor të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore dhe të të drejtave të grupeve. Në këtë kuadër një vend të veçantë do të zërë trajtimi i çështjes së gjykueshmërisë së këtyre të drejtave si element kyç për zbatimin e tyre dhe në të njëjtën kohë edhe si një sfidë ligjore për pjesën me të madhe të vendeve palë të traktatit mbi Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, por edhe të vendeve Evropiane. Një vëmendje të veçantë do t’i kushtohet sistemit rajonal Evropian të mbrojtjes së të drejtave të Njeriut, jo vetëm për faktin që është një ndër sistemet më të zhvilluara, por edhe për faktin që Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës dhe ka pranuar juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Krahas njohurive teorike mbi të Drejtave të Njeriut, lënda synon të pajisë studentët me njohuri praktike. Çështjet teorike janë analizuar duke u ilustruar vazhdimisht me raste të shumta nga praktika e organeve ndërkombëtare dhe praktika e organeve kombëtare të shteteve Palë të Larta Kontraktuese në instrumentet kryesore ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut.

Çështjet e trajtuara në tekst është e mundur të shtjellohen plotësisht nga pedagogu i lëndës dhe studentët brenda një viti akademik sipas sistemit të vjetër ose një semestri sipas sistemit të Deklaratës së Bolonjës, ne

ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve ose përafërsisht brenda 40 leksione – 20 seminare 50 min.

REZULTATET E TË NXËNIT

Pas përfundimit të kësaj lëndë, studenti duhet të jetë në gjendje të njohë sistemin universal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sistemet rajonale dhe e mekanizmat zbatues të tyre. Ai duhet të jetë në gjendje të njohë procedurat që zbatohen për vënien në lëvizje të mekanizmave mbrojtës të të drejtave të njeriut si në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Po ashtu, studenti duhet të jetë në gjendje të mundësojë zgjidhje për situata konkrete që mund të hasen në jetën e përditshme, veçanërisht ai duhet të njohës në detaje mekanizmat zbatues dhe garantues të Sistemit European Rajonal për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të krijuar në kuadër të Këshillit të Europës dhe veçanërisht në kuadër të Konventës Europiane të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Gjithashtu, studenti duhet të jetë në gjendje të kuptojë dhe të ndjekë të gjithë rrugët e ankimit kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut duke bërë të mundur ndër të tjera edhe përgatitjen e kërkesave ankimore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Mënyra sesi është konceptuar libri i cili shërben si literaturë bazë dhe mënyra e zhvillimit të leksioneve, seminareve dhe detyrave të tjera bën të mundur që studenti të edukohet me rëndësinë dhe nevojën për mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të Drejtave të Njeriut në kuadër të jetës së tyre të përditshme si dhe në kuadër të aktivitetit profesional që do të zhvillojë në të ardhmen. Temat e leksioneve, rastet e trajtuara në literaturën e përdorur, rastet e diskutuara në klasë si dhe objektivat e përcaktuara për këtë lëndë janë në përputhje të plotë edhe me rekomandimet dhe përfundimet e arritura nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e mbajtur në Vjenë në vitin 1993. Njohuritë konkrete që synon të transmetohen mund të përmblihen si vijon:

1. Filozofia dhe antropologjia: kuptimi i të Drejtave të Njeriut.
2. Burimet e të Drejtave të Njeriut, Sistemi Universal dhe sistemet rajonale për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
3. Marrëdhënia midis të normave të së Drejtës së Brendshme dhe normave të së Drejtës Ndërkombëtare, mënyrat e kufizimit të Drejtave të Njeriut.
4. Studimi i të Drejtave të Njeriut të grupuara sipas karakteristikave të përbashkëta të tyre, kuptimi i karakteristikave të veçanta dhe problematikës së zbatimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

POLITIKA E FREKUENTIMIT:

Frekuentimi i studentëve është i detyrueshëm ne masen 80% te oreve për lëndën

PLANI I ORËVE TEORIKE (40 orë)

Nr.	TEMA	ORË
1	HYRJE NË TË DREJTAT E NJERIUT I Çfarë studion lënda e të Drejtave të Njeriut? II E Drejta e të Drejtave të Njeriut dhe e Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut III Studimi i të Drejtave të Njeriut	2
2	KAPITULLI I Koncepti i të Drejtave të Njeriut 1.1 Shteti dhe të Drejtat e Njeriut 1.2 Individit Vlerat dhe universaliteti i të Drejtave të Njeriut	1
3	2.1 Traktatet	2

	<p>2.2 E Drejta Ndërkombëtare Zakonore</p> <p>2.3 Burimet dytësore të së Drejtës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut</p> <p>2.4 Parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e civilizuar</p> <p>2.5 E drejta e të Drejtave të Njeriut si pjesë e të Drejtës Ndërkombëtare Publike</p> <p>2.6 Statusi i shtetit dhe individit në të Drejtën Ndërkombëtare</p> <p>2.7 Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut</p> <p>E Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut</p>	
4	<p>KAPITULLI III</p> <p>Përgjegjësia e Shtetit për të Mbrojtur të Drejtat e Njeriut</p> <p>3.1 Përgjegjësia që buron nga e Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut</p> <p>3.2 Përgjegjësia që buron nga kushtetutat kombëtare</p> <p>3.3 Përgjegjësia që buron nga aktet e tjera kombëtare</p> <p>3.4 Raporti midis të Drejtës Ndërkombëtare dhe Drejtës Kombëtare ose të Drejtës së Brendshme Shtetërore</p> <p>3.4.1 Teoria Moniste</p> <p>3.4.2 Teoria Moniste e Ndërsjellët</p> <p>3.4.3 Teoria dualiste</p> <p>3.4.4 Teoria e harmonizimit</p> <p>3.5 Trajtimi modern i raportit midis normave të së Drejtës Ndërkombëtare dhe të Drejtës së Brendshme</p> <p>3.6 Zbatimi i normave të së Drejtës Ndërkombëtare në sistemin e të Drejtës së Brendshme</p> <p>3.7 Mënyrat e zbatimit të së Drejtës Ndërkombëtare në sistemin e së Drejtës Shtetërore</p> <p>3.8 Mjetet me anë të të cilave një shtet mund të shprehë pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga një traktat</p> <p>3.8.1 Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të nënshkrimit</p> <p>3.8.2 Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur nga një shkëmbim i instrumenteve që ligjërojnë një traktat</p> <p>3.8.3 Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të ratifikimit, pranimit ose miratimit</p> <p>3.8.4 Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të aderimit</p> <p>3.8.5 Shkëmbimi ose depozitimi i instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit</p> <p>3.8.6 Mjetet e tjera të shprehjes së vullnetit për t'u lidhur me një traktat</p> <p>3.9 Renditja e normave të së Drejtës Ndërkombëtare në hierarkinë e akteve normative në kuadër të së Drejtës së Brendshme të shteteve</p> <p>Statusi i normave të së drejtës ndërkombëtare që bien ndesh me normat e të Drejtës së Brendshme</p>	3
5	<p>KAPITULLI IV</p> <p>Të Drejtat e Njeriut dhe aktorët jo shtetëror</p> <p>4.1 OJQ-të dhe të Drejtat e Njeriut</p> <p>4.2 Të Drejtat e Njeriut dhe mundësimi i ndihmës humanitare nga OJQ-të</p> <p>4.3 Deklarata e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut</p> <p>4.4 OJQ-të dhe mbledhja e të dhënave mbi të drejtat e Njeriut</p> <p>4.5 OJQ-të në sistemin e OKB-së</p> <p>Të Drejtat e Njeriut dhe zbatimi horizontal</p>	1
6	<p>KAPITULLI V</p> <p>Zhvillimi e përsosja e të Drejtave të Njeriut dhe OKB-ja</p> <p>5.1 Zhvillimi i të Drejtave të Njeriut dhe OKB-ja</p> <p>5.2 Organet e të Drejtave të Njeriut sipas Kartës së OKB-së</p> <p>5.3 Këshilli i të Drejtave të Njeriut</p> <p>5.4 Procedura e rishikuar e ankimit në Këshillin e të Drejtave të Njeriut ose</p>	3

	Procedura 1503 5.5 Procedura 1235 5.6 Komiteti Këshillues i Këshillit të Drejtave të Njeriut 5.7 Organet e të Drejtave të Njeriut sipas traktateve 5.8 Sistemi i ankimit dhe procedurat 5.9 Detyrimi i organeve të OKB-së për të respektuar të Drejtat e Njeriut	
7	KAPITULLI VI Sistemi Evropian për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut 6.1 Zhvillimi i mekanizmave rajonale 6.2 Sistemi rajonal Evropian 6.2.1 Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) 6.2.2 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) - E drejta e ankimit - Kushtet që duhen plotësuar për pranimin e kërkesës - Procedurat pranë Gjykatës 6.2.3 Ndryshimet që do të sjell Protokolli Nr.14 i KEDNJ 6.2.4 Skema e shqyrtimit të çështjes në GJEDNJ 6.3 Komisionari Evropian për të Drejtat e Njeriut 6.4 Bashkimi Evropian (BE) 6.4.1 Karta e Lirive dhe të Drejtave Themelore 6.5 OSBE 6.5.1 ODIHR ose Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut 6.5.2 Përfaqësuesi i medias 6.5.3 Komisionari i Lartë për Pakicat Kombëtare 6.6 Instrumente të tjerë të rëndësishëm në kuadër të Sistemit Rajonal Evropian 6.6.1 Karta Sociale Evropiane 6.7 Matriksi i sistemit Evropian	7
8	KAPITULLI VII Sisteme të tjera rajonale për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut 7.1 SISTEMI AMERIKAN 7.1.1 Traktatet e të Drejtave të Njeriut në Amerikë 7.1.2 Komisioni Ndër-Amerikan - Procedura para komisionit 7.1.3 Gjykata Ndër-Amerikane - Juridiksioni dhe funksionimi i Gjykatës - Katalogu i të Drejtave dhe Lirive në Sistemin Amerikan 7.2 SISTEMI AFRIKAN 7.2.1 Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve 7.2.2 Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve - Procedimi i Komisionit 7.2.3 Instrumente të tjera 7.2.4 Gjykata Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve - Bashkimi (Unioni) Afrikan - Instrumente të tjera Afrikane 7.3 Sistemi i Lindjes së Mesme dhe Sistemi Aziatikë	4
9	Kapitulli VIII Kufizimi i të Drejtave të Njeriut 8.1 Kufizimi i të Drejtave të Njeriut nga shteti	2
10	Kapitulli IX Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore 9.1 Diskutim i përgjithshëm	2

	<p>9.2 Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (ESCR) si të drejta të Njeriut dhe lidhja e tyre me të drejtat civile e politike (CPR)</p> <p>9.3 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore</p> <p>9.4 E drejta për një standard minimal jetese, duke përfshirë të drejtën për ushqim, veshje, strehim dhe ujë</p> <p>9.5 E drejta për shëndet</p> <p>9.6 E drejta për arsim</p> <p>9.7 E drejta për siguri sociale</p> <p>9.8 E drejta për punë dhe kushte të nevojshme</p> <p>9.9 E drejta për të krijuar sindikata dhe e drejta e grevës</p> <p>9.10 E drejta për jetë kulturore</p> <p>9.11 Gjyqeshmëria e të drejtave ekonomike, sociale kulturore</p>	
11	<p>Kapitulli X</p> <p>Ndalimi i Torturës, e Drejta e Jetës, Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar</p> <p>10.1 Ndalimi i torturës dhe çfarëdo lloj trajtimi çnjerëzor dhe degradues</p> <p>10.2 E drejta për të jetuar</p> <p>10.2.1 Dënimi me vdekje</p> <p>10.2.2 Armët bërthamore</p> <p>10.3 Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar</p>	2
12	<p>Kapitulli XI</p> <p>Ndalimi i Diskriminimit, Diskriminimi Pozitiv, e Drejta për Siguri, e Drejta për Proces të Drejtë</p> <p>11.1 Ndalimi i diskriminimit</p> <p>11.2 E drejta për siguri e personit</p> <p>a. Heqja e lirisë si pasojë e një vendimi të një gjykate kompetente</p> <p>b. Heqja e lirisë për shkak të mos zbatimit të një urdhri të dhënë nga Gjykata</p> <p>c. Arresti dhe paraburgimi me qëllim dërgimin përpara autoritetit gjyqësor kompetent</p> <p>d. Heqja e rregullt e lirisë së një të mituri</p> <p>e. Heqja e rregullt e lirisë së një personi të dyshuar se mund të përhapë një sëmundje ngjitëse, heqja e lirisë së një të çmenduri, të një të alkoolizuari, të një toksikomani ose të një vagabondi</p> <p>f. Heqja e lirisë në rastin e dëbimit dhe të ekstradimit</p> <p>2. E drejta për informim për arsyet e arrestimit dhe të akuzës që rëndon ndaj tij</p> <p>3. E drejta për t'u dëgjuar nga një gjyqtar</p> <p>4. E drejta për të kërkuar kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së heqjes së lirisë (<i>Habeas Corpus</i>)</p> <p>5. E drejta për kompensim për shkak të heqjes së paligjshme të lirisë</p> <p>11.3 E drejta për proces të drejtë</p> <p>11.3.1 Procedimi penal</p> <p>a. E drejta për t'u drejtuar një gjykate të pavarur dhe të paanshme</p> <p>b. E drejta për një proces gjykimi brenda një afati të arsyeshëm dhe proces të hapur</p> <p>c. Gjykimi në mungesë "<i>in absentia</i>"</p> <p>d. Parimi i barazisë së mjeteve ose "armëve"</p> <p>e. Arsyetimi i vendimeve dhe e drejta për të mos dëshmuar kundra vetës</p> <p>f. Prezumimi i pafajësisë (<i>in dubio pro reo</i>)</p> <p>g. E drejta për t'u vënë në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe në mënyrë të hollësishme</p> <p>gj. E drejta për kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për përgatitjen e</p>	2

	mbrojtjes h. E drejta për t'u mbrojtur vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi i. E drejta për t'u ndihmuar falas me një përkthyes - Ndalimi i dënimit të pa parashikuar në ligj - Ndalimi i gjykimit dhe i dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale (Ne bis in idem) 11.4 Diskriminimi pozitiv	
13	Kapitulli XII E Drejta e Shprehjes, e Drejta e Mendimit, e Drejta e Ndërgjegjes dhe e Besimit, e Drejta Organizimit dhe Tubimit 12.1 Test i përgjithshëm për të përcaktuar një dhunim të të drejtave të shprehjes 12.2 E drejta e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit 12.3 E drejta e lirisë së shprehjes dhe mendimit 12.4 E drejta e organizimit dhe tubimit	3
14	Kapitulli XIII E Drejta e pronës, të Drejtat e Pakicave, Demokracia, e Drejta e Jetës Private dhe Familjare, të Drejtat e Fëmijëve dhe të Grave 13.1 E drejta e pronës 13.1.1 Mbrojtja e të drejtës së pronës në të Drejtën Ndërkombëtare 13.1.2 Mbrojtja e pronës nga Kushtetuta e RSH 13.2 Demokracia 13.2.1 Marrëdhënia ndërmjet të drejtës së pronësisë private dhe demokracisë 13.3 Të drejtat e pakicave 13.4 E drejta për jetë private dhe familjare 13.4.1 Mbrojtja e jetës private 13.4.2 E drejtat e respektimit të vendbanimit 13.4.3 Mbrojtja dhe respektimi i korrespondencës 13.4.4 Mbrojtja e jetës familjare 13.4.5 E drejta për të formuar familje 13.4.6 Barazia ndërmjet bashkëshortëve 13.5 Mbrojtje e veçantë për fëmijët dhe gratë	2
15	Kapitulli XIV Të Drejtat e Grupeve, e Drejta e Vetëvendosjes, e Drejta për Zhvillim, e Drejta për Paqe, e Drejta për Ambient të Përshtatshëm, e Drejta Ndërkombëtare Humanitare, Përgjegjësia Penale Ndërkombëtare e Individëve 14.1 E drejta e vetëvendosjes 14.2 E drejta për zhvillim 14.3 E drejta për paqe 14.4 E drejta për një mjedis të përshtatshëm 14.5 Zbatimi i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe përgjegjësia penale individuale ndërkombëtare 14.5.1 DNH dhe e Drejta e të Drejtave të Njeriut 14.5.2 Zbatimi i DNH 14.5.3 Përgjegjësia penale individuale ndërkombëtare	2
16	Kapitulli XV Strategjitë për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut	2
	TOTALI	40

PLANI I ORËVE PRAKTIKE (20 orë)

Nr.	TEMA	ORË
1	Diskutim në grupe i rasteve “Lihtenshtejn kundër Guatemalës”, [(1955) I.C.J. Reports 4. (GJND) dhe “Barcelona Traction, Light and Poëer Co case (Belgium v.Spain)” [1970] I.C.J. (GJND)	2
2	Diskutim në grupe i rastiteve <i>Nikaragua kundër SHBA-së</i> 1989 I.C.J 1986 (GJND), <i>Avena ose Meksika kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës</i> “Case Concerning Avena and Other Mexican Nationals (Mex. v. U. S.)”, 2004 I. C. J. 12 (<i>Avena</i>) dhe <i>Medellin kundër Texas NR. 06–984, shqyrtuar më 10 tetor 2007—dhe vendimin e datës 25 mars 2008. Vendimi i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara për rastin Medellin kundër Teksasit</i>	2
3	Prezantim i punimeve me shkrim nga studentët të ndarë në grupe pune	1
4	Hartim i një ankimi për Komitetin e të Drejtave të Njeriut	2
5	Hartim i ankimi për në Këshillin e të Drejtave të Njeriut	2
6	Hartim i një ankimi sipas procedurave 1035 dhe 1235.	1
7	Hartim i një ankimi individual sipas KEDNJ	1
8	Diskutim i rasteve <i>Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë 1987 (GJEDNJ)</i> , <i>Ergi kundër Turqisë (GJEDNJ)</i> , <i>Luizidou kundër Turqisë (GJEDNJ)</i> dhe <i>Sadam Hyseini kundër Forcave të Kualicionit dhe Oçalan kundër Turqisë (GJEDNJ)</i> .	2
9	Prezantim i punimeve me shkrim nga studentët të ndarë në grupe pune	2
10	Gjyq imitues, rast nga GJEDNJ	2
11	Gjyq imitues, rast nga sistemi i OKB-se	1
12	Gjyq imitues, rast nga sistemi Afrikan	2
	TOTALI	20

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

1. **Leksione,**
2. **Referime me gojë të studentëve në orët e mësimit,** sipas tematikave të dhëna paraprakisht. (Dorëzimi i materialit të referimit, për rivlerësim)- çdo javë.
3. **Dy detyra kursi** - në mes dhe në fund të kursit.
4. **Mjete audiovizive të përdorura :** *Kompjuteri dhe projektimi*

VLERËSIMI

- | | |
|--|----------------------------|
| a) Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | 20 % e notës përfundimtare |
| b) Prezantime gjatë semestrit | 30 % e notës përfundimtare |
| c) Provimi | 50 % e notës përfundimtare |

Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:

Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	Nota me shkronja
96 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A+
86- 95	9	Shumë mirë	A

76-85	8	Mirë	B +
66-75	7	Kënaqshëm	B
56 – 65	6	Mjaftueshëm	C
50 – 55	5	Kalueshëm*	D
≤49	4, 3, 2, 1, 0	Mbetës	F
		E papërfunduar**	PP
		Nuk ka të dhëna***	NDH

* Kredite të patransferueshme

** E papërfunduar

Një notë e papërfunduar mund t'i shënohet një studentit në qoftë se ai nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e lëndës deri në fund të semestrit, por ka kryer një sasi të konsiderueshme të punës. Është përgjegjësi e studentit të njoftojë pedagogun dhe të arrijë një marrëveshje për plotësimin e pjesës tjetër të lëndës. Në qoftë se kërkesat nuk plotësohen brenda një viti, atëherë automatikisht shënohet notë pakaluese.

*** Nuk ka të dhëna për notën

Ky shënim do të vendoset në pasqyrën e rezultateve të studentit në atë rast kur studentit është regjistruar për lëndën dhe nuk është shënuar asnjë notë nga pedagogu. Kjo nuk ka efekt në mesataren e studentit dhe mund të shndërrohet në notë numerike dhe me shkronjë, atëherë kur pedagogu vendos notën në procesverbal.

LITERATURA E REKOMANDUAR

Literatura e detyrueshme

1. Jordan Daci, Ed. "Erik" Tirane 2008, "*Te drejtat e njeriut*", Botimi II
2. Jordan Daci, Prishtine 2007, "*Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: juridiksioni, e drejta e ankimit dhe procedurat*"; Revista e "Drejta", Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës. Viti XXXII – No.1-4/2007. ISSN 0350-7890
3. Jordan Daci, Prishtine 2006, "*Zbatimi i së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare*". Revista "Tribuna Juridike" Nr. 58 Prill 2006.
4. Jordan Daci, Prishtine 2004, "*Statusi Juridik i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*". Revista Studime Juridike të Qendrës Juridike të Kosovës, Vëllimi nr.7 në Dhjetor 2004.

Literatura ndihmese

1. Donna Gomien. "*Udhëzues i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut*". Këshilli i Evropës 2005. Shtypur nga Gent Grafik. Tiranë 2005.
2. Krzysztof Drzeñicki. "Ndërkombëtarizimi i të Drejtave të Njeriut". *Hyrje në të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut*. Botuar nga Rija Hanski Markku Suksi. Instituti i të Drejtave të Njeriut, Universiteti i Abo Akademisë. 1999.
3. Nowicki Marek Antoni. "*Rreth Konventës Europiane: Komentari i shkurtër mbi Konventën Europiane të Drejtave të Njeriut*". Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut. 2003.

4. OSCE-ODIHR. *“Mbrotjtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut ”*. OSCE- Albin, Tiranë 2000.
 5. *“Për një Rend Publik Evropian: vendime të zgjedhura të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut ”*. Vëllimi I. Botim i Këshillit të Evropës dhe Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (QSHDNJ). Tiranë 2001.
1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
 2. Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e BE-së
 3. Konventa Europiane Kuadër për Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare
 4. Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut së bashku me 14 Protokollat shtesë të saj.

Hartuesi

Dr. Ervis Martani